



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
-AUTORITETI I KONKURENCËS-

**NJOFTIM PARAPRAK PËRQËNDRIMI**

**(Rasti Trema Engineering 2 Shpk— Strabag SE)**

Në datën 21 Janar 2008, Autoriteti i Konkurrencës ka marrë njoftimin e përqendrimit të propozuar në përputhje me nenin 10, pika 1, shkronja b të Ligjit Nr.9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, sipas së cilit shoqëria Strabag SE me seli në Villach, Austri, përfton kontroll nëpërmjet blerjes të pjesës prej 51% të kapitalit aksionar të shoqërisë Trema Engineering 2, me seli në Tiranë, Shqipëri.

Ky transaksion, sipas marrëveshjes së shitjes së aksioneve nënshkruar nga palët pjesëmarrëse është kryer në datën 14 Janar 2008.

1. Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse është:

- **Shoqëria Strabag SE** ushtron veprimtari në tregun ndërkombëtar kryesisht në: Austri, Gjermani, Hungari, Çeki, Poloni, Sllovaki, Kroaci, Rusi, Sloveni, Rumani, Bullgari, Serbi, Mal i Zi, Zvicër, Vendet e Beneluks etj, për:

Ndërtime civile dhe ekonomike;

Ndërtim rrugësh; dhe

Ndërtim tunelesh dhe shërbime të ndryshme në .

- **Shoqëria Trema Engineering 2 Shpk** ushtron veprimtari në tregun kombëtar për:

Ndërtime civile dhe projektimi:

2. Nga shqyrtimi paraprak, Autoriteti gjeti, që transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit dhe do t'i nënshtrohet procedurës së kontrollit të përqendrimeve të përcaktuar në nenin 56 të Ligjit dhe në Rregulloren “Për Zbatimin e procedurave të Përqendrimit të Ndërmarrjeve”.

3. Autoriteti fton palët e treta për të shprehur opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet duhet të paraqiten jo më vonë se 15 ditë nga publikimi i këtij njoftimi.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (nr 0355 4 234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr “Sami Frashëri”, Nr 4 Tiranë; apo me e-mail në adresën [competition@caa.go.al](mailto:competition@caa.go.al).